



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:128904

Datë: 25.11.2019

Numri i dokumentit: 00752254

C.nr.1015/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Habib Zeqiri, si gjyqtar individual, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit H.R nga, Komuna Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. I.S me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “.....” me seli në Prishtinë, për çështjen kontestuese kompensim i dëmit, në seancën kryesore të mbajtur me dt.15.11.2019, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, mori ndërsa më dt. 25 nëntor 2019 shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET, pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit **H.R** nga Fshati, Komuna Ferizaj, dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “.....” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 27.06.2018, t’ia paguaj edhe atë:

- Për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....9.500,00€
- Për dhimbje trupore –fizike.....3000,00€
- Për frikën e shkaktuar.....1000,00€
- Për Shëmtim.....2000,00€
- Për rehabilitim terapeutik.....210,00 €
- Për fitimin ushqimin e përforcuar.....200,00 €
- Faktura mjekësore.....562.16 €

Gjithsej shumën 16472,16 €, (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy euro e gjashtëmbëdhjetë cent) të cilën lartësi e paditura DETYROHET që t’i kompensoj paditësit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi dhe atë me kamatë prej 8 % duke filluar nga data 19.10.2018 deri në pagesën definitive.

II. DETYOHET e paditura që paditësit të ja kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1163 € në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

III. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e miratuara në lartësi prej 46801.14 € (dyzetë e gjashtëmijë e tetëqind e një euro e katërbëdhjetë cent) dhe pjesa tjetër e kërkesës për shpenzimet e procedurës në lartësi prej 548.60 € (pesëqind e dyzetë e tetë euro e gjashtëdhjetë cent) si të pa bazuar.

A r s y e t i m i

Paditësi Hamit Reka, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi në gjykatë më dt.19.10.2018 lidhur me kompensim dëmi material dhe jo material, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 27.06.2018, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve ‘‘.....’’ me seli në Prishtinë.

Lidhur me këtë gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor më 15.11.2019, në të cilën i autorizuari i paditësit av. I.S deklaroi: pas administrimit të provave në këtë gjykatë është vërtetuar në tërësi baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, andaj i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë si të bazuar si në precizimin e kërkesëpadisë të dt. 15.11.2019.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, në seancën e shqyrtimit kryesore dhe fjalën përfundimtare deklaroi: duke mbetur pranë deklarimeve si më lartë dhe pas administrimit të provave e paditura e konteston bazën juridike pjesërisht sa i përket kontributit të paditësit në rritjen e vëllimit të dëmit në mos përdorimin e rrypit të sigurisë dhe po ashtu i konteston shumat e kërkuara me anë të precizimit të kërkesëpadisë pasi që shumat e kërkuara janë tejet të larta dhe në shpërputhje me qëllimin e kompensimit kjo pasi që në çdo rast për dëmin jo material duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim duke kujdesur që kompensimi të jetë satisfaksion për palën e dëmtuar dhe asesi qëllime tjera materiale që mund të biejn ndesh me këtë qëllim.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit kryesore ka bërë administrimin e provave dhe atë janë lexuar si prova: raporti i aksidentit 2018-CF-361 dt. 27.06.2018; vendimi nr. 732 i dt.

14.09.2018 lëshuar nga e paditura; foto-dokumentacioni mjekësor; kopje të kuponave fiskal; Mendimi dhe konstatimi i ekspertëve mjekësor Dr. A.T dhe Dr. N.M dt. 07.03.2019; Ekspertiza Mjeksore nga Kirurgu Maxillofacial Dr. NJ.H.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit **është e pjesërisht e bazuar**.

Fillimisht gjykata vlerëson se në mes palëve pjesërisht ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, ndërsa kontestuese ka qenë lartësia e saj. Paditësi përmes të autorizuarit të tij av. I.S, ka kërkuar kompensim dëmi në lartësi të përgjithshme prej 63.273,30 €, ndërsa e paditura përmes përgjigjes në padi, por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë, ashtu që edhe përmes përgjigjes në padi por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka ofruar paditësit shumën prej 9004.88 €, për të gjitha format e kompensimit material dhe jo material.

Në lidhje me këtë gjykata ka konstatuar se në bazë të shkresave të lëndës ekspertizës së ekspertit të komunikacionit thënieve të palëve në procedurë, ekziston lidhja kauzale në mes lartësisë së dëmit të shkaktuar paditëses dhe veprimeve të siguruarve të paditurve në këtë aksident.

Sa i përket bazës juridike, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndarje të përgjegjësisë, ngase nga përshkrimi i raportit të policit hetues, i cili raport është pjesë e raportit të përgjithshëm të aksidentit nuk rezulton asnjë lloj përgjegjësie apo ndonjë kontribut eventual i paditësit në drejtim të aksidentit të komunikacionit, andaj në rastin konkret bëhet fjalë për përgjegjësi ekskluzive e të siguruarit të paditurës. Për më tepër dyshimet eventuale për ndarje të përgjegjësive të ngritura nga e paditura, kanë mundur të evitohen gjatë rrjedhës së kësaj procedure, duke propozuar ndonjë ekspertizë të komunikacionit, gjë që e paditura nuk e ka bërë, andaj gjykata e ka marrë si të saktë përpilimin e atij raporti sa i përket përgjegjësive.

Lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së, dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 169 par.3, 174, dhe 961 të LMD-së, duke u bazuar në mendimin e ekspertizave mjekësore, dhe atë përmes ekspertizës Neurogjike, Psikiatrike dhe Maksillofaciale, si dhe dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës të cilat janë administruara si prova në këtë çështje juridike.

Sa i përket shumave të aprovuara si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata është bazuar kryesisht në praktikën gjyqësore, pasi që në rastin konkret bëhet fjalë për lëndime të rënda trupore edhe pse fillimisht sipas mendimit të ekspertit të ortopedisë Dr. A.T është konstatuar se lëndimet trupore për paditësin janë të lehta. Megjithatë po sipas këtij mendimi, është rekomanduar që sa i përket regjionit të fytyrës të deklarohet kirurgu maksillofacial, e që pas kësaj rrethane, është propozuar dhe rrjedhimisht aprovuar propozimi për nxjerrjen e provës nga ekspertiza e kirurgut maksillofacial, cili pos tjerash ka konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Për më tepër si pasojë e lëndimeve, është konstatuar se për paditësin ekziston zvogëlim i përgjithshëm i aktivitetit jetësor në shkallë prej 15 %, për shkak të thyerjeve të kockave të fytyrës si dhe kockës supraorbitale. Mes tjerash si vazhdimi i këtij konstatimi është theksuar se ka pasur pirje të dhëmbëve të sipërme për shkak të lëndimit të nervit infratorbital të anës së djathtë dhe ‘është i përhershëm’. Mpirja e dhëmbit në këtë rast e cilësuar si e përhershëm tregon për një natyrë më të rëndë të lëndimit ngase kjo gjendje do ta përcjellë paditësin për një kohë të gjatë apo ndoshta edhe përjetësisht. Andaj mbi këto arsye është vendosur që paditësi të kompensohet në lartësi prej 9500 €, të vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket dhimbjeve fizike, gjykata ka vendosur që paditësi të kompensohet në lartësi prej 3000 €, duke u bazuar në dy ekspertizat (Ortopedisë dhe Maksillofaciale) të cilat pak shumë janë të njëjta në konstatime, e që nuk përcaktojnë kohëzgjatje të theksuar të dhimbjeve tek paditësi, pavarësisht faktik se i njëjti ka pësuar lëndime të rënda trupore, andaj gjykata vlerëson se shuma e aprovuar është reale me karshi dhimbjeve të përjetuara.

Po ashtu nga ekspertiza e ekspertit maksillofacial është konstatuar se paditësi ka pasur shëmtim, andaj gjykata ka aprovuar shumën prej 2000 €, edhe pse shëmtimi konsiderohet i shkallës së lehtë, megjithatë bëhet fjalë për pjesë të ndjeshme të trupit siç është fytyra.

Lidhur me frikën e përjetuar, gjykata ka vendosur që paditësi të kompensohet në lartësi prej 1000 €, dhe atë ndaras nga lëndimet e përjetuara, sepse ekspertja Dr. N.M në mendimin e saj të dhënë në ekspertizë ka konstatuar frikën e që nënkupton se frika (sidomos primare) nuk ka zgjatur shume tek paditësi.

Po ashtu edhe sa i përket formave tjera të së drejtës për kompensim dhe atë; për rehabilitim terapeutik, fitimin e ushqimit të përforcuar dhe për faturat mjekësore, gjykata kryesisht është bazuar në mendimet e ekspertëve si dhe provat që gjinden në shkresat e lëndës.

Si rrjedhojë e kësaj, gjykata vlerëson se shuma e përgjithshme e aprovuar në lartësi prej 16472,16 €, (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy euro e gjashtëmbëdhjetë cent) është reale dhe e mjaftueshme që t'u përgjigjet nevojave të paditësit, që i njëjti këtë shumë ta përjetoj si satisfaksion në raport me aksidentin e përjetuar të komunikacionit.

Gjykata vendimin e saj për lartësinë e kërkesëpadisë e ka bazuar në bazë të praktikës gjyqësore, e duke vendosur sipas bindjes së lirë, në mungesë të një vlerësimi të saktë përmes ndonjë ekspertize, dhe atë bazuar në nenin 323 të LPK-së, i cili nen përcakton: *po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla.....por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave.....gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë.*

Gjykata ka vlerësuar edhe kundërshtimet e përfaqësuesit të paditurës në lidhje me vërejtjet në lidhje me lartësinë e kërkesë padisë së paditëses të cilat gjykata konsideroj se janë pjesërisht të bazuara dhe i ka marr parasysh me rastin e vendosjes, ndërsa ka vendosur përtej shumës së ofruar, nga arsyet e lartëcekura.

Sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e miratuar në lartësi prej 46801.14 € (dyzetë e gjashtëmijë e tetëqind e një euro e katërmëdhjetë cent) gjykata e ka refuzuar, pasi që shumat e kërkuara si në precizimin e kërkesëpadisë ishin shuma tepër të larta e të cilat nuk përkojnë me asnjë praktikë gjyqësore dhe nuk janë në harmoni me kriteret e kompanive të sigurimit. Këtë konkluzion gjykata e bazoi duke marr parasysh llojin e lëndimit të paditësit, dhimbjet e përjetuara si dhe pasojat tjera të aksidentit, e tërë kjo duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të mjekësisë si dhe krahasimin e praktikave gjyqësore lidhur me lëndimet dhe pasojat e ngjashme të këtij karakteri, e duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, në vlerësimin e lire ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e theksuar nga paditësi për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike.

Lidhur me lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit jo-material dhe material, gjykata paditësit ja ka njohur të drejtën në kamatë ligjore prej 8 %, prej datës. 19.10.2018 deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 lidhur me nenin 463 të LPK-së, andaj e paditura është obliguar që paditësit t'i paguaj shumën prej 1.163,00€ dhe atë 208 € për përpilim të padisë, për tri nga 135 €, përfaqësime në seanca shumën e tërësishme prej 405 €, për ekspertiza mjekësore shumën prej 450 €, dhe shumën prej 100 €.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
C .nr.1015/18 dt.25 nëntor.2019

Gjyqtari:
Habib Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.